



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**INSTITUTI I STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT**  
**BORDI**

Nr. 153 prot

73

Tiranë më 24/04/2025

**VENDIM**

**Nr. 3 ,datë 22.04.2025**

**PËR RISHIKIMIN E PLANIT TË PUNËS TË VITIT 2025**

**PËR RISHIKIMIN E RREGULLORES SË FUNKSIONIMIT TË BORDIT**

**PËR SHPALLJEN E POZICIONIT VAKANT TË POZICIONIT TË DREJTORIT  
EKZEKUTIV**

**PËR SHPALLJEN E POZICIONEVE VAKANTE PËR KËSHILLIN SHKENCOR**

Në mbështetje të ligjit Nr. 10242 , datë 25.02.2010, " *Për Institutin e Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit* " i ndryshuar, neni 10 ,neni 11 gëрма "c" , "d" , "e" dhe gëрма "ë", neni 14, si dhe të " *Kodit të Proceduarave Administrative të Republikës së Shqipërisë*," Kreu I, " Akti Administrativ" në përfundim të mbledhjes Bordi :

**V E N D O S I**

1. Ndryshimin e periudhës së studimit të pikës 16 të Planit Vjetor të Punës te vitit 2025.
2. Ndryshimin e nenit XII të Rregullores për Funksionimin e Bordit si më poshtë:
  - pika 1 e nenit XII fjala Bordi Drejtues bëhet Bordi.
  - Pika a) e nenit XII ndryshon nga 60 ditë...në 40 ditë.
  - Pika d) e nenit XII ndryshon nga 30 ditë... në 20 ditë.

Caktimin e kritereve skualifikuese si më poshtë:

- Kriteri sipas Kreut IV , Neni 18 të ligjit të ISKK.

- Minimumi Master shkencor ose e barazvlefshme me të, në shkenca Shoqërore dhe Humane.
  - Eksperiencia e punës jo më pak se 10 vite pune.
3. Ngarkon ISKK që të shpallë pozicionin e Drejtorit Ekzekutiv sipas kritereve të përcaktuara për konkurim brenda datës 25.04.2025
  4. Ngarkon ISKK për të filluar me shpalljen e konkurimit për anëtarë të Këshillit Shkencor brenda datës 25.04.2025.

*Në mbledhje ishin të pranishëm gjithë anëtarët e Bordit dhe vendimet u morën me votim unanim.*

**KRYETARI I BORDIT**

**MENTOR BEQA**



*Konceptori: L.Aliko* 



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**INSTITUTI I STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT**  
**BORDI**

Nr. 153/prot  
12

Tiranë më 24/04 / 2025

**PROCESVERBAL**

**MBLEDHJE BORDI**

( Datë, 22/04/2025 )

Sot është ditë e martë, data 22.04.2025, ora 14:00.

**Të pranishëm nga Bordi:** Z.Vasil Tole, Z.Mentor Beqa, Znj.Alma Mirakaj, Znj.Etleva Smaçi, Z.Simon Mirakaj, Z.Niuton Mulleti, Znj.Laureta Roshi.

**Të pranishëm nga Instituti :** Z.Çelo Hoxha

**Rendi i ditës i dakortësuar është si më poshtë:**

- I. Diskutime mbi Planin Vjetor të Punës të ISKK;
- II. Diskutime mbi fillimin e procesit të përzgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv të ISKK;
- III. Diskutime mbi fillimin e procesit të përzgjedhjes së Këshillit Shkencor të ISKK;
- IV. Diskutime te tjera.

**Mbledhja drejtohet nga Kryetari i Bordit Z.Mentor Beqa**

**Hapet Mbledhja**

**M.Beqa:** Hapim diskutimet për pikën Nr.I diskutime mbi Planin Vjetor të punës së ISKK.

**A.Mirakaj:** Te pika 16 e Planit të Punës ku thotë përkthimi i dokumentave nga gjuha jugosllave në gjuhën shqipe, periudha që përmendet këtu është periudha e cila është e kufizuar nga ligji i ndryshuar i ISKK.

Përsa i përket pikës së teksteve shkollore për rishikimin e tyre, dua të di nëse ka një marrveshje me Ministrinë e Arsimit për rishikimin e teksteve të historisë.

Pyetja tjetër është për pikën e planit për anketën që është në plan. Dua të di se ku ka arritur puna për realizimin e kësaj ankete.

**M.Beqa:** Faleminderit, fjalën e ka znj.Etleva.

**E.Smaçi:** Kur u propozua për rishikim plani nuk m'u duk me vend të bëhej rishikim i tij pasi ai është duke u zbatuar. Më duket një plan ambicioz. Mendoj se vetë ISKK nuk është shumë e kthjellët, pasi mora pjesë te tryesa pashë që kalonte në anën e ekstremit. Mendoj se tekstet shkollore janë një kafshatë shumë e madhe për Institutin. ISKK duhet të bëjë një lloj kontrolli të popullatës për atë se çfarë dinë brezat për komunizmin. Pika e rishikimit të teksteve nuk duhet të preket nga Instituti.

**L.Roshi:** Unë mendoj se rishikimi i teksteve është një e domosdoshme shumë e madhe. Në Ministrinë e Arsmit është Drejtoria e Kurrikulave, dhe në bashkëpunim me të mund të rishikohen. Duhet të qëndroj në plan dhe të bëhet puna me shumë transparent nga grupi i punës që do të merret me këtë projekt.

**A.Mirakaj:** Une kam dhe një pyetje tjetër për planin për anketën. Dua të di se ku ka arritur puna për realizimin e kësaj ankete.

**Ç.Hoxha:** Ka një opinion të krijuar për pjesën e kufizimit të ligjit. Në nenin 5 të ligjit janë të shprehura qartë detyrat e Institutit.

Sipas citimit të këtyre neneve të ligjit të ISKK këtu është baza ligjore për dokumentat për përkthim nga ana jonë.

Për pikën e dytë për rishikimin e teksteve. Ne do të shikojmë njëherë këto tekste madje edhe me një komision. Pas rishikimit do të bëjmë propozimet tona.

**M.Beqa:** Për diskutimin e pikës së parë për përkthimin e dokumentave, mendoj se përkufizimi i ligjit ka të bëjë me krimet në periudhën e komunizmit, ndaj nuk besoj se fryma e ligjit e kufizon këtë pikë të planit të punës.

Doni ta hedhim në votë këtë pikë të planit?

**V.Tole:** Unë jam dakort me Almën. Kufizimi i periudhës kohore u vendos nga Kuvendi dhe mendoj se kjo periudhë nuk duhet të përfshihet në planin e punës.

Për tekstet unë jam dakort që këto duhen të studiohen nga ISKK. Mendoj që të përfshihen disa tema për periudhën e komunizmit.

**E.Smaçi:** Nga pikëpamja ligjore ne nuk duhet ta përmendim këtë përiudhë kohore.

Do të ishtë më mirë të propozohet një modul me zgjedhje vetëm për periudhën e komunizmit.

**V.Tole:** Pra mbetet si pikë që të rishikohet kurrikula.

**S.Mirakaj:** Ne nuk e shohim si një e keqe e të përbashkët komunizmin. Nëse do ta shohim si e keqe e përbashkët krijohet një tolerancë dhe frymë bashkëpunimi.

**N.Mulleti:** Në nenin 5 të ligjit si e tha dhe Drejtori besoj se studimi i komunizmit dhe pasojave të tij është detyrë e Institutit dhe objekti kryesor i tij.

**M.Beqa:** Përkufizimi është ky dhe mendoj se këtij përkufizimi duhet ti përbahet ISKK. Mendoj se kemi të bëjmë me një mosmarrveshje dhe ta hedhim në votë.

**V.Tole:** Mendoj se atë që përcakton ligji ne nuk mund ta hedhim në votim.

**E.Smaçi:** Atë që ta kufizon ligji nuk mund ta anashkalojmë.

**V.Tole:** Në program nuk duhet të figurojë më vitet 1942-1943.

**M.Beqa:** ISKK është për studimin e krimeve dhe pasojave të komunizmit. Nëse ne e kufizojmë, i bie nuk i studion dot pasojat e komunizmit.

**L.Roshi:** Unë mendoj se nuk përbën problem.

**E.Smaçi:** Nuk besoj se duhet të flasim për pasoja kur ne hymë në demokraci. Por mund të flitet për pasojat e integrimit pas komunizmit.

A mund t'i ndryshohet titulli studimit për të cilin ne po flasim, pika 16 e planit të punës?

**M.Beqa:** Jeni dakort që te plani te pika 16 të bëhet ndryshimi i periudhës se studimit?

*Anëtarët e Bordit miratuan ndryshimin e periudhës së studimit të pikës 16 të planit të punës. Ky ndryshim u miratua me votim unanim.*

**M.Beqa:** Studimi i kurrikulës mbetet pa ndryshuar. Mbyllim diskutimet për pikën e I të rendit të ditës.

Hapim diskutimin për pikën II të Rendit të ditës që është pika për procesin e zgjedhjes së Drejtorisë së Institutit.

**V.Tole:** Unë propozoj mos pjesmarjen e Drejtorisë së Institutit në këtë diskutim për arsyet e tij.

*Të gjithë anëtarët ishin dakort me propozimin e Z.Vasil. Drejtori Ekzekutiv nuk mori pjesë në këtë diskutim.*

**M.Beqa:** Përpara se të hap diskutimet, të bëj disa sqarime.

Burimet njerëzore na kanë konfirmuar se ka përfunduar mandati i drejtorisë, ka përfunduar disa muaj më parë. Për shkak të mos zgjedhjes së Bordit, procesi nuk ka përparuar sipas parashikimeve ligjore. Së dyti, Drejtori Ekzekutiv nuk është nëpunës civil. Njësia përgjigjegjëse nuk ka arritur t'i japë një përgjigje nëse duhet ta shpallim apo jo vendin vakant, duke qënë se jemi në periudhë zgjedhore. Këto janë shkruar në raport nga ana e njësisë së burimeve njerëzore. Ligji i Krijimit të ISKK te nisi 11, pika b) thotë se Bordi zgjedh Drejtorin dhe pika e) miraton kriteret e kualifikimit dhe procedurat e marrjes në punë për punonjësit e Institutit.

Ligji nuk futet më thellë se cilat janë detyrat e Bordit në raport me zgjedhjen e Drejtorisë, por këtë gjë na e sqaron Rregullorja e Bordit në ninisht 12 të saj.

*Kryetari i Bordit citon ninisht 12 te Rregullores se Bordit.*

Njoftimi është bërë dhe ne jemi në pikën që ka një konfuzion për shkak të periudhës zgjedhore nëse na lejohet të shpallet apo jo. Vaso ka sqarim për këtë çështje.

**V.Tole:** Ne jemi totalisht të vonuar në këtë çështje. Unë kam pasur një komunikim për këtë çështje dhe ndalesa është për të gjithë dhe se ne deri në 11 maj nuk duhet të kemi vendimmarrje për zgjedhje, por kjo nuk na pengon se të shpallim njoftimet dhe vendimin ta marrim kur të vijë momenti që është pas periudhes së zgjedhjeve.

Unë do t'ju nxitja të nderuar kolegë që ne të bënim shpalljen, pasi kriteret janë aty dhe ne të përcaktojmë afatet dhe duke bërë edhe llogaritjet për mos humbur kohë.

**L.Roshi:** Edhe unë jam dakort që të bëhet shpallja dhe të kufizohet edhe koha.

**V.Tole:** Edhe unë jam që ne kur të bëjmë shpalljen e kritereve ta shkurtojmë kohën pasi koha 60 ditë është kur Bordi do të ishte në vazhdimësi dhe shpallja do të bëhej në kohën e duhur. Ideja është që brënda majit ne ta mbyllim si procedurë. Ne e kemi dhe në dorë ta ndryshojmë afatet.

**M.Beqa:** Nëse doni që ne të ndryshojmë rregulloren, e ndryshojmë.

**V.Tole:** Jo unë mendoj të ndryshojmë vetëm pikën e afatit , ku thotë jo më pak se 60 ditë, ta bëjmë jo më pak se 40 ditë.

**L.Roshi:** Unë mendoj që ne të shpallim pozicionit e Drejtorit dhe të marrim përsipër rishikimin e rregullores.

**V.Tole:** Kur bëhet shpallja e pozicionit, shpallen edhe afatet për dokumentacionin, për ankesat, për konkurrimin ndaj duhet t'i ndryshojmë.

**S.Mirakaj:** Shpallet vendi vakant dhe do t'ju jepet një kohë e caktuar kandidatëve për të sjellë dokumentacionin.

**M.Beqa:** I nisim me radhë.

Faza e parë konsiston në këto veprime:

- a. Shpallja e procedurës së konkurrimit dhe të gjithë hapat e tjerë bëhen në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të ISKK, dhe në ambientet e brendshme të ISKK, të paktën 60 (gjashtëdhjetë) ditë përpara datës të parashikuar për zhvillimin e konkurrimit.
- b. Shpallja mbahet në portal, faqen e internetit dhe në ambientet e brendshme të ISKK për të gjithë kohën deri në shpalljen e fituesit.

**V.Tole:** Të ndryshohet kjo datë.

**E.Smaçi:** Të ndryshojmë këtë afat që është këtu.

**L.Roshi:** Po të ndryshohet data të jetë një afat më i shkurtër.

**N.Mulleti:** Nëse do të preket rregullorja do të sugjeroja që të ndryshohet edhe fjala Bordi Drejtues pasi bie ndesh me ligjin ku Bordi nuk përmendet si Bordi Drejtues, por vetëm fjala Bordi.

**M.Beqa:** Mos ndoshta ky afat që është më i shkurtër ia kufizon të drejtën e konkurrimit atyre që duan të konkurojnë.

**E.Smaçi:** Unë mendoj se ky afat është i mjaftueshëm dhe nuk pengon.

**V.Tole:** Unë mendoj se nuk përbën më sens 60 ditë, pasi kanë kaluar afatet që në dhjetor dhe ne si Bord i ri duhet ta zgjidhim sa më shpejt këtë pjesë.

**N.Mulleti:** Duhet të marrim parasysh që mund të ketë kandidatë të pakënaqur me procesin dhe mund ta ankimojnë në gjykatë. Për këtë arsy, çdo ndryshim i afateve duhet pasqyruar fillimisht në rregullore para se të bëhet shpallja e fillimit të procesit.**M.Beqa:** Unë doja të bënim një mbledhje të posaçme për rregulloren pasi shoh se ka shumë probleme në rregullore. Sipas kësaj rregulloreje, Bordi nuk thirr dot mbledhje pa propozimin e Drejtorit.

**V.Tole:** Ke të drejtë por ne e kemi në ligj që Bordi mund të mblidhet në mbledhje edhe pa propozimin nga Drejtori. Nuk funksionon rregullorja para ligjit, kur ajo bie ndesh me ligjin, zbatohet ligji dhe jo rregullorja.

**S.Mirakaj:** Unë them të ndryshojë rregullorja.

**M.Beqa:** Pra propozimi është për të ndryshuar afatet nga 60 dite në 40 ditë?

**V.Tole:** Po jam dakort për 40 ditë që të mbarohet afërsisht nga fundi i majit.

**L.Roshi:** Dakort për këtë afat.

Une do të propozojë edhe një ndryshim për dosjet që të shkojnë direkt në Bord dhe jo në Burimet Njerezore.

- M.Beqa:** Këtu janë të përcaktuara se ku shkojnë në fillim pastaj do na përcillen ne.
- V.Tole:** Unë mendoj se nuk ka asgjë që të venë në Institut dhe pastaj ato do na përcillen ne.
- M.Beqa:** Ndryshimet e afateve që u propozuan i hedhim në votë nëse jeni të gjithë dakort.

*Bordi mori vendim me votim unanim për të ndryshuar :*

*pika 1 e nenit XII ffala Bordi Drejtues bëhet Bordi.*

*Pika a) e nenit XII ndryshon nga 60, në 40 ditë.*

*Pika d) e nenit XII ndryshon nga 30 ditë , në 20 ditë.*

*Pjesa tjetër e afateve mbetet e pandryshuar, si dhe këto ndryshime të paraqiten në vendimin përkatës.*

**M.Beqa:** Pasi bëmë ndryshimet në afate, ne duhet të plotësojmë kriteret, pasi nuk na kanë ardhur kritere nga instituti. Këtu nuk janë të qarta kriteret skualifikuese.

**V.Tole:** Kriteret janë në rregullore.

**N.Mulleti:** Mendoj se problemi thelbësor qëndron te vetë rregullorja se përzihen dy gjëra që nuk duhet të përzihen. Përzihen funksionet e Bordit me procedurën e zgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv. Por në kushtet që jemi duhet të qartësojme pikat që janë të domosdoshme. Kritere përjashtuese janë arsimi Master Shkencor dhe vitet e punës.

**V.Tole:** Këto janë kritere skualifikuese, por mund të vendosen edhe kritere të tjera që mund të shënohen se përbëjnë avantazh.

**M.Beqa:** Kriteret skualifikuese duhet të bëhen te shpallja që ta dinë se kush mund të aplikoje dhe kush jo. Nivelin e shkollimit e lemë Master apo Doktoraturë?

**V.Tole:** Ne e kemi bërë këtë diskutim, por numri i njerëzve që do të vinë për konkurrim do të ishte shumë i pakët. Dhe zgjodhëm minimum Master Shkencor dhe çdo lloj grade që do të sjellte kandidati do të ishte avantazh.

**M.Beqa:** Dua të shtoj se ky është një institucion me karakter kërkimor, i krijuar me ligj nga Kuvendi dhe ne nuk i japim dinjitetin që i takon, dhe e lëmë me master.

**E.Smaçi:** Ky vërtet mbasë është një Institut kërkimor, por ka më shumë punë administrative, përmua do të ishte mirë të vinin Profesora, por nuk vjen njeri me këtë gradë të konkurojë. Unë mendoj që duhet ta lëmë kërkeshën e arsimit aq sa është me Master Shkencor.

**A.Mirakaj:** Unë them ta lëmë kështu si është.

**L.Roshi:** Eshtë avantazh pasja e Gradave Shkencore

**N.Mulleti:** Si është avantazh eksperiencia në pozicione drejtuese, të jetë avantazh edhe pasja e Gradave Shkencore.

**M.Beqa:** Ramë dakort që kritere skualifikuese të janë Master Shkencor dhe eksperiencia në punë minimalisht 10 vite. Përbëjnë avantazh titujt shkencorë dhe eksperiencia e punës në pozicione drejtuese.

**V.Tole:** Mendoj të vendosim dhe moshën si kriter.

**L.Roshi:** Unë mendoj se nuk mund të vendosim moshën, pasi do të ishte një kriter diskriminues,

**Mentor Beqa:** Tani shohim për gjuhën e huaj. Unë nuk do zgjidhja një drejtor që nuk flet anglisht, pasi ai do të shkonte në takime brënda vendit dhe takime me homologë jashtë vendit

apo në koferenca dhe ne nuk mund ta dërgojmë me përkthyes. Nuk e di nëse mund ta vendosim si kriter skualifikues.

**E.Smaçi:** Unë mendoj se duhet ta lëmë si avantazh gjuhën e huaj.

**L.Roshi:** Kërkesa e gjuhës së huaj bie pasi në Master Shkencor jepet me detyrim.

**S.Mirakaj:** Unë them se duhet të jetë gjuha e huaj si kriter.

**M.Beqa:** Tani marrim një vendim për çfarë u diskutua për kriteret skulifikuese. Pra është një pikë për të ndryshuar rregulloren.

*U mor vendim me votim unanim për përcaktimin e kritereve skulifikuese që janë:*

-Kriteri sipas Kreut IV, Neni 18 të ligjit të ISKK.

-Minimumi Master shkencor ose e barazvlefshme me të, në shkenca Shoqërore dhe Humane

-Eksperiencia e punës jo më pak se 10 vite pune.

Këto ndryshime të pasqurohen në rregullore dhe vendim.

**M.Beqa:** Tani do bëhet shpallja e vendit vakant ku duke u mbështetur mbi ligjin e ISKK dhe rregulloren me këto ndryshimet që iu bënë dhe duke u bazuar ne vendimin e marrë sot.

**V.Tole:** Mund ta formuloni se Bordi i ISKK në mbledhjen e datës 22.04.2025 aprovoi kriteret dhe afatet për pozicionin e Drejtorit Ekzekutiv dhe të vendosni kriteret dhe afatet.

**M.Beqa:** Bordi ngarkoi ISKK që të shpallë pozicionin e Drejtorit Ekzekutiv sipas kritereve të përcaktuara për konkurim brenda datës 25.04.2025.

*Të gjithë anëtarët e Bordit ranë dakort për shpalljen e pozicionit të Drejtorit Ekzekutiv.*

**M.Beqa:** E mbyllëm edhe çështjen e dytë, vazhdojmë me diskutimin e çështjes së tretë për Këshillin Shkencor.

*Anëtarët e Bordit ishin dakort që në këtë diskutim të merrte pjesë edhe Drejtori Ekzekutiv z.Ç.Hoxha.*

**M.Beqa:** Ia japim fjalën z.Hoxha

**Ç.Hoxha:** Shumicës së anëtarëve iu ka përfunduar mandate, pasi edhe ata me janë me mandat 5-vjeçar. Mendoj se duhet të përgatisim një dokument me anëtarët që iu ka mbaruar afati.

**M.Beqa:** Unë kam këtë propozim: Ngarkohet Instituti të shpallë njoftimin për konkurim për Këshillin Shkencor të ISKK. Ata që janë me mandat të vazhdojnë mandatin, atyre që iu ka mbaruar mandati të shpallet konkurimi. Nuk ka nevoje të marrë vendim Bordi se kujt i ka mbaruar mandate, pasi ajo është proceduriale.

**E.Smaçi:** Mendoj se këtu duhet të ketë kritere për të pasur gradën shkencore “Doktor”, pasi është shumë e rëndësishme.

**N.Mulleti:** Po duhen të jenë.

**Ç.Hoxha:** Kriteret janë të përcaktuara në ligj.

**M.Beqa:** Aplikimi brënda 30 ditësh dhe keni 10 ditë ju që të na i përcillni. Shpallja për Këshillin të bëhet brenda datës 25.04.2025.

*Anëtarët e hodhën në votë dhe ranë dakort me votim unanim për shpalljen e konkurimit për anëtarë të Këshillit Shkencor dhe ngarkuan ISKK për të filluar me shpalljen.*


**M.Beqa:** Nëse nuk ka më diskutime për këtë pikë e mbyllim.

Pika e fundit është diskutime. Nëse dikush ka diçka për të shtuar apo çështje për të diskutuar.


*Anëtarët e Bordit nuk kishin çështje të tjera për dikutim.*

**M.Beqa:** Përderisa nuk keni gjë tjetër për të shtuar, e deklaroj mbledhjen të mbyllur.


**Mentor Beqa**.....  


**Simon Mirakaj**.....  


**Vasil Tole**.....  


**Etleva Smaçi**.....  


**Loreta Roshi**.....  


**Alma Mirakaj**.....  


**Niuton Mulleti**.....  


**Mbajti Provesverbalin: Liljana Aliko**

